# Studenti, provimet dhe libreza e tij

Që studenti të shohë rezultatet e provimeve që ka dhënë, atëherë ai duhet të identifikohet në faqen zyrtare të sistemit të menaxhimit të notave të tij, duke klikuar në linkun:

[https://www.unishk.esse3.u-gov.rash.al](https://www.unishk.esse3.u-gov.rash.al)




Pasi studenti identifikohet në sistem, i paraqitet përpara një faqe përmbledhëse me gjithë informacionet që kanë të bëjnë me karrierën e tij universitare (gjendja, programi, grupi, të dhenat e tij personale, etj)

## PROVIMET

Në këtë faqe studenti, për të parë notat që i ka vendosur pedagogu, duhet të klikojë në menu'në majtas PROVIMET.



# PASQYRA E REZULTATEVE

Pas klikon tek menuja PROVIMET, duhet të klikojë në nën-menunë PASQYRA E REZULTATEVE, ku do t'i paraqitet lista e provimeve për të cilat pedagogu ka vendosur një vlerësim (note). Keto rezultate do të rrinë në këtë faqe për 15 ditët e ardhshme që nga momenti që pedagogu i ka vendosur ato online.

(Pasi sekretaria të ketë ngarkuar procesverbalin në sistem keto vlerësime do t'i gjejë në Librezën e tij dixhitale).

Shënim: Përse duhet kjo faqja? Ky është momenti që studenti sheh noten, dhe bën ankimimet e nevojshme pranë pedagogut të tij i cili ende nuk e ka dorezuar procesverbalin në Sekretari.



# LIBREZA

Libreza – Libreza dixhitale e studentit përmbledh gjithë Planin Mësimor të studentit me gjithë lëndet/modulet e studentit deri në vitin akademik që ai është duke frekuentuar (studenti i kursit të dytë do shihte dhe lëndët/modulet e kursit të dyte pervec atyre të kursit të parë). Në librezë shfaqen vetëm notat pozitive




1. **DATA TË DISPONUESHME** – Janë gjithë datat e mundshme ku studenti mund të futet në provim
   a. Ikona P – Do të thotë që egziston një prenotim i studentit në një provim për atë lëndë. Nese klikon mbi të, do të shohë detajet e prenotimit, të cilin dhe mund ta printojë.
   b. Fletorja me vizë – Do të thotë që nuk ka datë të disponueshme për provim. Kjo vlen si për lëndët të cilat ende nuk janë dhënë, si për lëndët për të cilat është dhënë një vlerësim në momentin që studenti viziton Librezen e tij.
2. **KURSI** – Është kursi kur studenti duhet të japë lëndën që ndodhet në atë rresht.
3. **Veprimtaria Mesimore** – Është emërtimi i veprimtarisë mësimore (lënda/moduli) që studenti ka në planin e tij mësimor.
4. **Gjendja e Veprimtarise Mësimore**
   i. P – Lënda është thjesht e Planifikuar
   ii. F – Lënda është Frekuentuar
   iii. S – Lënda është dhënë dhe studenti ka marrë një notë pozitive
5. **Viti Akademik i Frekuentimit** – Në rastin kur gjendja e Veprimtarisë është F apo S, atëherë viti akademik i frekuentimit mban vitin në të cilin studenti ka frekuentuar veprimtarinë.
6. **KREDITE** – Janë kreditet që ka secila veprimtari.
7. **DATE KALIMI** – Kur gjendja e Veprimtarisë është S (Kaluar), atëherë në këtë kolone gjejmë dhe datën e provimit kur studenti është futur në provim dhe ka marre notë pozitive.
8. **VLERESIMI** – Kur gjendja e Veprimtarisë është S (Kaluar), atëhërë në këtë kolonë gjejmë dhe notën përfundimtare që studenti ka marrë në rastin kur kjo notë është pozitive.
9. **DETAJE** – Duke klikuar mbi ikonën, në faqen që na paraqitet studenti gjen gjithe detajet e provimeve qe ai ka bërë për një veprimtari të caktuar (psh. nëse studenti është futur 3 herë në provim, dy here ka marrë katër,njëherë 5 etj, studenti gjithë detajet e këtyre provimeve i gjen në këtë faqe.